

PROGRAMI MASTER (MSc.)
MENAGJIMI I INSTITUCIONEVE DHE SHERBIMEVE SHENDETESORE

SHKENCAT SHËNDËTËSORE INFERMIERI

SHKENCAT TERAPEUTIKE

SHKENCAT DIAGNOSTIKE

PEDAGOGJIA PROFESIONALE NË SHËNDËTËSI / FUSHA PROFESIONALE INFERMIERI

SHKENCAT STUDIMORE BACHELOR (BSc.)



Në këto vite të funksionimit të qeap-heimerer, kemi krijuar një koncept të arsimit dhe kualifikimit të qëndrueshëm, që garanton cilësi dhe siguri. Fokusi ynë është i përqendruar në studentin si individ, prandaj edhe e gjithë mësimdhënia dhe puna praktike organizohet sipas filozofisë sonë institucionale "Studenti në Qendër". Përmes jetësimit konsekuent të kësaj filozofie arrihet cilësia e synuar në punën e studentëve dhe docentëve, që rezulton në kënaqshmëri të lartë të klientëve/pacientëve dhe gjithë partnerëve tanë bashkëpunues.

Petrit BEQIRI, Drejtor

PEDAGOGJIA PROFESIONALE NË SHËNDETËSI / FUSHA PROFESIONALE INFERMIERI



PPSH:

Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi/Fusha Profesionale Infermieri" u mundëson të diplomuarve të kenë kualifikim profesional pedagogjik shëndetësor. Studentët aftësohen të organizojnë, realizojnë dhe menaxhojnë në mënyrë të pavarur informimin, edukimin dhe këshillimin e pacientëve dhe procesin e mësimin shëndetësor në institucionet shëndetësore dhe arsimore.

Fushat e angazhimit

Pas përfundimit të suksesshëm të programit të studimeve, kandidatët janë të përgatitur të angazhohen me sukses në këto hapësira profesionale brenda sistemit shëndetësor dhe arsimor të Republikës së Kosovës, Rajonit dhe Evropës

- Informim, këshillim dhe edukim shëndetësor me qëllim parandalimi
- Informim, këshillim dhe edukim shëndetësor të pacientëve
- Ofrim autonom i shërbimeve profesionale të kujdesit infermior në nivelin primar, sekondar dhe terciar
- Angazhim në edukim në shkollat e përgjithshme dhe profesionale
- Evidence based Nursing (ofrimi i shërbimeve infermiore të bazuara në evidencë)
- Realizimi i projekteve hulumtuese.

SHKENCAT DIAGNOSTIKE

Radiologji

Teknikët e Radiologjisë janë ekspert për zbatimin e procedurave imazhuese në mjekësi, të cilat përdoren në fushat speciale të radiologjisë diagnostike e terapeutike si dhe radioterapisë. Teknikët e radiologjisë kanë ekspertizën mjekësore, fiziko teknike dhe radiologjike teknike për të realizuar të pavarur kontrollimet imazherike dhe për të trajtuar pacientin sipas udhëzimeve të radiologut.

Fushat e angazhimit

Teknikët e Radiologjisë mund të punësohen për të ofruar:

- Shërbime profesionale radiologjike të kujdesit primar, sekondar, terciar dhe në institucionet shkencore shëndetësore me shërbime radiologjike
- Menaxhim dhe mundësi udhëheqjeje të shërbimeve radiologjike primare, sekondare e terciare (diagnostike dhe terapeutike).

Laborator

Teknikët e Laboratorit janë kualifikuar profesionalisht për të kryer të gjitha llojet e diagnostikës laboratorike, duke përfshirë jo vetëm mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e mostrave biologjike (lëngje organike dhe inde), por edhe aplikimin e procedurave komplekse laboratorike, vlerësimin dhe interpretimin e rezultateve, mbledhje e të dhënave, zgjidhjen e problemeve, zbatimin e kontrollit të cilësisë, e kështu me radhë. Stafi i laborantëve punojnë në ekipe me specialistë të profesioneve laboratorike, mjek specialist të fushave klinike, infermierë dhe profesionistë tjerë të shëndetit si pjesë e sistemit me pacientin në qendër.

Fushat e angazhimit

Teknikët e Laboratorit mund të punësohen për të ofruar:

- Shërbimeve profesionale laboratorike në nivelin primar, sekondar dhe terciar në të gjitha institucionet shëndetësore
- Punë në të gjithë llojet e laboratorëve në mjekësi dhe në degët e ngjashme (veterinë, biologji, industri farmaceutike), puna në laboratorët kërkimor dhe në laboratorët e institucioneve edukative
- Realizim të projekteve hulumtuese



Misioni

Misioni i “qeap-heimerer” është të implementojë planprogramet mësimore me mësimdhënës të kualifikuar dhe metodologji bashkëkohore, që mundëson arritjen e standardeve evropiane për edukim të profesionistëve shëndetësor, duke rezultuar në cilësi të matshme të shkathtësive dhe njohurive profesionale.

Institucioni ynë synon që përmes programeve studimore të ofrojë formimin dhe avancimin e aftësive individuale të studentëve për të përfutur dije e për ta përdorë atë në interes të individit e të shoqërisë.

Duke ofruar një arsimim cilësor dhe të orientuar në kërkesat e shoqërisë dhe tregut, “qeap-heimerer” synon mbështetjen e edukimit të shoqërisë me vlerat demokratike dhe qytetare dhe njëkohësisht ngritjen e shprehive të suksesit në ekonominë e tregut

Vizioni

Vizioni i “qeap-heimerer” është të jetë shkollë udhëheqëse në Kosovë dhe rajon për arsimin profesional në fushat e Shëndetësisë dhe Infermierisë.

Objektivat

- qeap-heimerer është shkolla më cilësore në rajon, që ofron kualifikime të njohura ndërkombëtarisht
- qeap-heimerer është e hapur për të gjithë njerëzit në shërbim të marrjes dhe dhënies së dijes në profesionet shëndetësore
- qeap-heimerer përgatit kadro profesionale të afta dhe të gatshme për tregun e punës
- qeap-heimerer ka shkallë të lartë bashkëpunimi me shkolla dhe universitete evropiane me traditë të dëshmuar të cilësisë, duke vazhduar ta rris ofertën e programeve studimore në varësi me kërkesat e tregut kosovar dhe evropian

Logopedi

Logopedia është një profesion shëndetësor-terapeutik, që ndihmon klientin të cilin ballafaqohen me probleme të ndryshme në gjuhë dhe të folur. Logopedi merret me procedurat e vlerësimit dhe trajtimit terapeutik të klientëve me çrregullime në komunikim dhe gjuhë, të fëmijëve dhe të rriturit. Terapija logopedike është thellësisht e bazuar në evidencë shkencore dhe në parime biomjekësore. Studentët e logopedisë janë të privilegjuar të jenë pionierë në këtë profesion në Kosovë dhe rajon.

Fushat e angazhimit

Logopedët janë ekspertë për trajtim të çrregullimeve komplekse të komunikimit dhe shërbimet e tyre i ofrojnë në mjedise të ndryshme si më:

- Spitale, klinika dhe ordinanca publike dhe private
- Qendra rehabilituese, Qendra të Shëndetit Mendor, Institucione për përkujdesje të të moshuarve, institucionet e kujdesit të specializuara
- Punëtori Strehuese, shkolla, çerdhe dhe ndërmarrje



Ergoterapi

Ergoterapia është Terapi e Punës, që ndihmon klientin/pacientin të rikthejnë aftësitë e humbura për përfshirje të pavarur në të gjitha aktivitetet e jetës. Të gjithë klientët që kanë humbur aftësitë e tyre punuese për shkak të ndonjë sëmundjeje a çrregullimi, për shkak të moshës ose pengesave zhvillimore mund të gjejnë ndihmën e Ergoterapeutit. Studentët mësojnë si të punojnë me klientin e të gjitha moshave dhe si t'i zbatojnë teoritë ergoterapeutike në praktikë. Studentët e ergoterapisë janë të privilegjuar të jenë pionierë në këtë profesion në Kosovë dhe rajon.

Fushat e angazhimit

- Ergoterapeutët mund t'i ofrojnë shërbimet e tyre në një popullatë të gjerë, në mjedise të ndryshme, si në:
- Spitale, klinika dhe ordinanca publike dhe private
 - Qendra rehabilituese, Qendra të Shëndetit Mendor, Institucione për përkujdesje të të moshuarve
 - Punëtori Strehuese, shkolla dhe ndërmarrje

Infermieri

Programi i studimeve Bachelor “Infermiera e Përgjithshme” është një program që ka për qëllim aftësimin e profesionistëve të infermierisë, të cilët do të jenë në gjendje të veprojnë të pavarur, por edhe të marrin pjesë aktive në bashkëpunimin ndër-disciplinar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, në harmoni me zhvillimet shoqërore, shkencore dhe teknologjike.

Fushat e angazhimit

Infermierët e diplomuar mund të angazhohen në këto hapësira profesionale:

- Ofrimi i pavarur dhe menaxhimi i shërbimeve profesionale të kujdesit infermior në nivelin primar, sekondar dhe terciar në të gjitha institucionet shëndetësore
- Menaxhimi i rasteve / Menaxhimi i kujdesit
- Evidence based Nursing (ofrimi i shërbimeve infermierore të bazuara në evidencë)
- Realizimi i projekteve hulumtuese



Geriatrri

Programi i studimit Bachelor “Infermiera e Përgjithshme: Profili Geriatri” zhvillon profesionalisht dhe kualifikon infermierë me njohuri dhe kompetenca të larta profesionale për kujdesin për të moshuarit. Si bazë e përgjithshme e infermierëve konsiderohen njohuritë dhe të kuptuarit e shkencave infermierore, shkencat bazë mjekësore si dhe shkencat sociale, të cilat integrohen dhe përdoren në praktikën e infermierisë geriatrike. Rëndësi të njëjtë kanë edhe të kuptuarit dhe njohuritë për qasjet e ndryshme të infermierëve në nivelin e komunikimit dhe zhvillimit të kujdesit kritik infermior. Kjo reflekton zhvillimin e shkathtësive sa më të mira në ofrimin e shërbimeve infermierore.

Fushat e angazhimit

Infermierët e diplomuar në profilin geriatrik mund të angazhohen në këto hapësira profesionale:

- Ofrimi i pavarur dhe menaxhimi i shërbimeve profesionale të kujdesit infermior në nivelin primar, sekondar dhe terciar në të gjitha institucionet shëndetësore
- Ofrimi i pavarur i shërbimeve profesionale të kujdesit infermior për moshat geriatrike në shërbimet shtëpiake/ambulatore
- Menaxhimi i rasteve / Menaxhimi i kujdesit
- Evidence based Nursing (ofrimi i shërbimeve infermierore të bazuara në evidencë)Realizimi i projekteve hulumtuese



Programi i studimeve Master “Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore” ofrohet në kuadër të projektit Tempus të Bashkimit Evropian, i pari i këtij lloji, që mundëson bashkëpunimin publiko-privat në fushën e edukimit të lartë në Kosovë. Si i tillë është zhvilluar bashkërisht mes tri universitetesh: Universiteti i Shkencave të Aplikuara Münster, Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina dhe BprAL qeap-heimerer. Studentët do të shfrytëzojnë objektet dhe ekspertizën e këtyre institucioneve të arsimit të lartë në konsorcium. Mësimdhënësit janë ligjërues ndërkombëtarë. Organizimi i mobilitetit të studentëve përbën edhe bazën e programit studimor. Modulet dhe kurset me të cilat studentët diplomojnë nga këto institucione njihen automatikisht. Studentët e diplomuar bëhen ekspertë për të menaxhimit të institucioneve dhe shërbimeve shëndetësore. Grada/kualifikimi i përbashkët – që është kualifikim ndërkombëtarë – njihet zyrtarisht nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse të arsimit të lartë në program.

Fushat e angazhimit

Menaxherët e Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore mund të punësohen:

- Në të gjitha institucionet dhe repartet e kujdesit primar, sekondar, terciar
- Në të gjitha institucionet shkencore shëndetësore Në të gjitha institucionet edukative-arsimore shëndetësore

Programi Master Shkencor (MSc) zgjat 2 vite (4 semestra) dhe ka 120 ECTS.



Rruga europiane drejt karrieres suaj profesionale

Të gjitha programet tona të studimeve Bachelor (BSc) janë të AKREDITUARA dhe të LICENCUARA në Kosovë dhe të njohura në tërë botën. Programet e studimeve zgjatin 3 vite (6 semestra) dhe kanë nga 180 ECTS.

Praktikat klinike në institucionin tonë përbëjnë gjysmën e orëve të programeve studimore dhe kryhen në institucionet që ofrojnë kujdes shëndetësor në Kosovë, Rajon dhe në BE.

Studentët që tregojnë performancë të mirë profesionale gjatë praktikave në BE, kanë të siguruar Kontrata të Punës.